



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 425/ Prot

Dt. 15.02.22

Nr. 103/1 prot.

Shkodër, më 10.02.2022

LËNDA: Mbi vendimin Nr.04 datë 26.01.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.8743 dat.22.02.2001 dat.22.02.2001 "Për pronat e palujatshme të shtetit" i ndryshuar, ligjit Nr.8744 dat.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të palujatshme publike të shtetit në njësite e qeverisjes vendore" i ndryshuar, ligjit Nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Kreu VI, Shkresës së Sekretarit të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës Nr.420prot datë.1.02.2022 "Dërgim dokumentacioni shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës me dat.26.01.2022", **Shqyrtoi VKB Vau-Dejës nr.04 datë 26.01.2022** "Për miratimin e vazhdimet të procedurës për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau-Dejës, të pasurisë nr.371 ZK.3506 e llojit (pa fryt), në fshatin Stajkë, NJAD Bushat". Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Vëmendje strukturës përkatëse, pasi nuk është cituar në vkb fusha e përdorimit të pronës sipas funksioneve të parashikuara në zbatim të nenit 3 të ligjit Nr.8744 dat.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të palujatshme publike të shtetit në njësite e qeverisjes vendore" i ndryshuar dhe forma e transferimit të pronës, në zbatim të nenit 5 të ligjit Nr.8744 dat.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të palujatshme publike të shtetit në njësite e qeverisjes vendore" i ndryshuar.

Sjellim në vëmendje VKM Nr.500 dat.14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të palujatshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësite e qeverisjes vendore" i ndryshuar dhe Udhëzimet e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit Nr.3 dat.18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të palujatshme të shtetit nga njësite e qeverisjes vendore" dhe Udhëzimin Nr.15 dat.30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të palujatshme publike".

PREFEKTI

NE MUNGESË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Felek KASEMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KESHILLI BASHKIAK**



VENDIM

Nr 04 Datë 26.01.2022

Për miratimin e vazhdimit të procedurës për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, të pasurisë nr 371, Zk nr 3506, e llojit pa fryt, në fshatin Stajkë.

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, neni 9, pika 1.2, ligji nr 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. “, ligji nr 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht nenet 35,36,37,38 dhe 39, të KREUT IV, ”Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore”, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit nr 1 datë 12.01.2022, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit, Sektori i Aseteve, ku propozohet “Për miratimin e vazhdimit të procedurës për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau Dejës të pasurisë nr 371, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, në fshatin Stajkë”.

Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak

VENDOSI :

1. Miratimin e vazhdimit të procedurës, për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, të pasurisë nr 371, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31.01.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
Sektori i Aseteve

Nr -----Prot

Vau Dejës me -----2022

RELACION

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj si dhe nevojave për të vënë në eficence për qëllime zhvillimi ekonomik duke shfrytëzuar resurset nën juridiksionin e saj territorial, si dhe Sektori i Aseteve, në kuadër të përditësimit të pjesshem të pronave shtetërore, propozon që pasuria nr 371, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, me sipërfaqe prej 164 300 m2, e llojit “Pa fryt”, të fillojë procedurën për transferimin e kësaj pasurie në pronësi të Bashkisë Vau Dejës.

Nga ana e grupit të punës, është bërë verifikimi i gjendjes faktike në terren dhe është bërë Plan rilevimi përkatës i kësaj pasurie.. Kemi bërë kërkesë në ASHK dhe kemi marrë kartelën e kësaj pasurie, ku rezulton se kjo pasuri është pronë Shtet, e llojit “Pa fryt” me sipërfaqe 164 300 m2.

Në vazhdim, të procedurës, pas miratimit në këshill dhe shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti, dokumentacioni i përgatitur do përcillet për shqyrtim në ASHK, e cila më pas do hartojë dhe dërgojë në këshillin e ministrave projekt vendimin për transferimin në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, të kësaj pasurie.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë projekt vendim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli

PLAN RILEVIM



PERGATITI

Emri e mbiemri : Esmeraldo Harapi

Data e përgatitjes : 07.12.2021

Sipërfaqe: S=164 300 m²

IDENTIFIKIMI I PASURISE


ZONA KADASTRALE : 3506

NR PASURISE : 371 VOL. 3 FQ. 146

INDEKSI I HARTES : K-34-76-(4-A),(244-C)
SHKALLA : 1:2500

ADRESA E PASURISE : Rr.Shkoder F.Stajke

PRONARI: SHTET



VULA/ FIRMA



Vol. 3, Fq. 146

SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijn nga: Vol. Fq.

Zona Kadastrale: 3506 NR. i PASURISE: 371

Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ -->

Indeksi i Hartes: B-34-16-(4-1)

Adresa e pasurisë : Rrethi SHKODER Q/ë STAJAR

PERFUNDIMTARE (data): 21/11/1996

Rr/L. P/G Sh K Ap

SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Jon Pasurise : P. J. Brenda V.K.N. : Jo ---> Po, Ref :

Brenda V.K.N. : Jo ---> Po, Ref :

Përshkrim i Veçantë

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtësë
------------------------	----------------------------	------------------------------

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes:

%

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. _____ Fq. _____

SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
	12.03.1994	SHITLI			SHKOLLË - STAJKË				